

VENDIM
Nr. 109, datë 21.4.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 2” SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1081/1 prot., datë 17.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 2’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1081 prot., datë 3.4.2026, shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për saktësim/modifikim të aneksit A të licencës së saj, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 mw.

- Shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, të ndryshuar.

2. Përputhshmëria e aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4, të Rregullores, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave “a”, “d”, “f” dhe “g”.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të japë informacion mbi numrin e njësive të depozitimit të energjisë elektrike dhe kapacitetin e secilës.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të saj, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës.

- Germa “e”: Shoqëria duhet të japë informacion mbi fazën ku ndodhet ndërtimi i centralit, informacion i cili shërben për qëllimet e këtij aplikimi dhe në kuadër të rishikimit të kushtit të operimit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253/2023, i ndryshuar.

- Po ashtu, në kuadër të informacionit shtesë, vlerësohet t’i kërket shoqërisë të informojë mbi mënyrën e financimit të këtij investimi.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., në kushtet kur kërkesa për modifikim lidhet me shtimin e njësive të depozitimit të energjisë elektrike, si vepra ndihmëse të centralit, çështje që lidhen me aktet e miratuara prej tyre, aspektet mjedisore të projektit dhe operimin e centralit në raport me sistemin elektroenergjetik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 20 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti